



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 963/11 Prot.

Tiranë, më 20.10 2016

V E N D I M

“Mbi lejimin e transferimit ndërkombëtar”

Nr. 69, datë 20/10 2016

Në mbështetje të nenit 9 dhe pikës 1 të nenit 26 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës administruar me nr. 963 prot, datë 16.09.2016, për pajisje me autorizim për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale nga transferuesi **BANKA KOMBËTARE TREGTARE S.H.A** në marrësin **MASTERCARD PAYMENT TRANSACTION SERVICES TURKEY**;

K O N S T A T O V A :

Subjekti kontrollues, Banka Kombëtare Tregtare Sh.a ka kërkuar nga Autoriteti i Komisionerit pajisjen me autorizim për transferimin e të dhënave personale në marrësin Mastercard Payment Transaction Services të vendosur në Ayazağa Mahallesi Mezarlık Sokak No:3, Sarıyer 34396 İstanbul – TURKEY.

Sipas deklarimeve të subjektit kontrollues, në *Formularin e Aplikimit për Aproximin e Transferimit të të Dhënave Personale në një Shtet që nuk ka Nivel të Mjaftueshëm të Mbrojtjes së të Dhënave Personale*, administruar pranë KDIMDP, transferimi që kërkohet të autorizohet nga Autoriteti i Komisionerit përmban elementët e mëposhtëm:

Kategoria e të dhënave objekt transferimi:

1. Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
2. Numri personal i identifikimit;
3. Jeta profesionale;
4. Situata ekonomike e financiare;
5. Adresa, karakteristikat e banesës;
6. Të dhëna kontakti, gjeneralitete.

Shteti ku do të realizohet transferimi: Turqi.

Kategoria e subjekteve të cilëve u transferohen të dhënat personale janë: Klientë.

Frekuenca e Transferimit është: Vazhdimisht, sa herë të jetë e nevojshme.

Qëllimi i transferimit, citojmë: *"Kompania turke ofron procesimin (sistemin, përpunimin, mirëmbajtjen, etj) e kartave të BKT-së (të të gjitha llojeve si debiti, krediti etj) dhe shërbimet që lidhen me to. Për këtë arsye kompanisë do i duhen disa të dhëna të domosdoshme të klientëve të BKT-së për të përmbushur shërbimin që kanë rënë dakort në marrëveshje mes palëve".*

Ndërkohë në Rubrikën 7, të Formularit të Aplikimit "Rrethanat lidhur me përpunimin" subjekti transferues ka deklaruar, citojmë: *"Kompania me të cilën BKT ka lidhur kontratën për të përmbushur shërbimin, duhet të procesojë kartat (debit dhe kredit) duke përdorur sistemin me të dhëna personale të klientëve të BKT-së. Këto të dhëna që do të transferohen janë të domosdoshme për identifikimin e kartëmbajtësit dhe funksionimin e kartave (si psh blerje online, dërgim statementi, etj) dhe do të përdoren vetëm gjatë kohëzgjatjes së kontratës dhe me përfundimin e saj këto të dhëna do të shkatërrohen".*

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave, citojmë: *"MC PTS ofron sistemin e kartave dhe mirëmbajtjen e tij. Aksesimi i të dhënave të klientëve të rregjistruara në këtë sistem përdoret në masën dhe përsa është e nevojshme për funksionimin e kartave. Këto të dhëna përdoren vetëm gjatë kohëzgjatjes së kontratës dhe me përfundimin e saj do të shkatërrohen".*

Në bazë të Vendimit të Komisionerit Nr. 3, datë 20.11.2013 "Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale", Turqia nuk është në listën e vendeve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Në këto kushte në zbatim të nenit 9 pika 1, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, subjekti kontrollues Banka Kombëtare Tregtare Sh.A është në kushtet ku ky transferim duhet kryer pas marrjes së Autorizimit nga Komisioneri mbi ligjshmërinë e realizimit të tij.

Për këtë qëllim subjekti përveç Formularit të Aplikimit ka depozituar një sërë dokumentesh në mbështetje të kërkesës së tij për të legjitimuar transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale në marrësin e sipërcituar dhe konkretisht:

Kontratën për transferimin e të dhënave, *"Marrëveshje për Shërbime Emetuese ndërmjet Bankës Kombëtare Tregtare dhe Mastercard Payment Transaction Services Turkey Bilişim Hizmetleri Anonim Şirketi"*, Anex Klauzola Standarte Kontraktuale, Shtojca 1,2,3,4 dhe 5, *"Deklaratën e Pëlqimit të Klientit të përfshirë në Kontratën e Shërbimeve Bankare Individuale"*.

Në mbështetje të dokumentacionit të paraqitur nga kontrolluesi dhe studimi i përmbajtjes së tyre rezultojnë që ky transferim të dhënash personale të jetë në përputhje me respektimin e mbrojtjes së të dhënave personale sipas akteve ndërkombëtare Direktiva 95/46/EC dhe vendase, dispozitat e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 41, datë 13.06.2014 për "Lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale".

Sa më sipër, kërkesa për marrjen e autorizimit nga Komisioneri për transferimin e të dhënave personale nga kontrolluesi Banka Kombëtare Tregtare Sh.a, plotëson kërkesat ligjore për t'u pajisur me Autorizim për transferimin e të dhënave personale të kërkuara;

### PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, shkronja b, c nenit 9, pika 2 dhe nenit 26 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;

### V E N D O S A :

1. Lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale nga kontrolluesi **Banka Kombëtare Tregtare Sh.a**, duke përcaktuar si më poshtë:

Kontrolluesi **Banka Kombëtare Tregtare Sh.a** lejohet të transferojë tek marrësi i të dhënave **Mastercard Payment Transaction Services** të vendosur në Ayazağa Mahallesi Mezarlık Sokak No:3, Sarıyer 34396 İstanbul – TURKEY kategorinë e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave klientë, si më poshtë:

- Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
- Numri personal i identifikimit;
- Jeta profesionale;
- Situata ekonomike e financiare;
- Adresa, karakteristikat e banesës;
- Të dhëna kontakti, gjeneralitete.

2. Të dhënat e cituara më sipër do të transferohen vetëm për qëllimin e deklaruar nga transferuesi në Formularin e Aplikimit për Autorizim mbi Transferimin e të Dhënave Personale, të paraqitur pranë Komisionerit dhe që ka të bëjë me procesimin (sistemin, përpunimin, mirëmbajtjen, etj) e kartave të BKT-së (të të gjitha llojeve si debiti, krediti etj) dhe shërbimet që lidhen me to.
3. Të dhënat personale të lejuara për t'u transferuar (parashikuar në pikën 1), do të përpunohen/ruhen vetëm për qëllimin e lejuar (parashikuar në pikën 2) deri në përfundim të marrëveshjes për shërbimet emetuese. Këto të dhëna nuk mund të përpunohen/ruhen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin e marrëveshjes.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dzyzetë e pesë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u dha sot më datë 20/10 2016

**Beshnik DERVISHI**  
  
**KOMISIONERI**